



Universiteti "Fan S. Noli"
FAKULTETI I EKONOMISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
FAKULTETI I EKONOMISË
KORÇË

Adresa: Shëtitörja "Rilindasit" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580
Web: www.unkorce.edu.al e-mail: rektorati@unkorce.edu.al

DEPARTAMENTI FINANCË-KONTABILITET

MIRATOHET:

REKTORI

Prof. as. dr. GJERGJI MERO

FAKULTETI I EKONOMISË

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

“MASTER I SHKENCAVE”

NË FINANCË

Viti akademik 2014-2015

DEKANI

Prof.as.dr. FREDERIK ÇUÇLLARI

PËRGJEGJËS I DEPARTAMENTIT

Prof.as.dr. ALKETA PASHOLLI

1. EMËRTIMI I PLOTË I PROGRAMIT TË STUDIMIT:

MASTER I SHKENCAVE NË FINANCË

2. VENDIMET E ORGANEVE PËRGJEGJËSE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT:

NIVELI I MASTERIT	SASIA E KREDITEVE
SHKENCOR	120
Vendimi i Senatit akademik të UK për hapjen e programit Master (numri i vendimit & data)	Urdher Nr.575 date 20.11.2012 Mash
Fillon më:	Tetor 2014
Përfundon më:	Korrik 2016

3. OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MUNDËSITË QË AI I OFRON STUDENTIT PËR PUNËSIM

Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Korçës është vatra e formimit të ekonomistëve të rinj të qarkut të Korçës dhe jo vetëm. Janë keta ekonomistë që do të zbatojnë politikat integruese të BE. Në kohët e sotme moderne të tendecave të globalizimit dhe të levizjes së lirë të kapitaleve kërkohet një përgatitje më e mirë e specialistëve të fushës së financës, të cilët do të jenë të aftë të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me kërkesat bashkëkohore. Masteri i shkencave në Financë ka një rol të rëndësishëm në përgatitjen e kuadrove të lartë të këtij profili. Duke qenë se në botën e sotme novacioni është bërë element dominues në kontekstin e zhvillimeve ekonomiko-sociale, pozohen sfida të reja ndaj bizneseve dhe manaxhimit financiar të tyre. Këto sfida nuk mund të përballohen me zgjidhjet e së shkuarës edhe pse ato mund të kenë qenë të suksesshme. E tashmja dhe vecanërisht e ardhmja kërkon perspektiva të reja, zgjidhje të reja dhe manaxherë e drejtues financiarë me koncepte të reja.

Qëllimi kryesor i Masterit Shkencor në Financë është t'u japë studentëve njohuri të nevojshme, të avancuara, në fushën e financave, duke iu krijuar premisa për zhvillim në karrierë apo studime të mëtejshme në nivel doktore.

Programi i Ciklit të Dytë të Studimeve Universitare “Master i shkencave” ka si mision:

- a. Të përgatisë profesionistë të përgatitur me standardet më të larta të mundshme për Shqipërinë.
- b. Të mbështesin kultivimin e vlerave të ekonomise në Shqipëri.
- c. Të ndihmojnë shoqërinë shqiptare në procesin e integritit evropian.

Figura profesionale bazë, që formohet nëpërmjet këtij programi, është ajo e drejtuesit financiar të niveleve të ndryshme, i cili është në gjendje të punësohet në kompanitë e biznesit apo dhe në institucionet shtetërore përgjegjëse për proceset e mbledhjes dhe menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve publike, Banka Qendrore, institucione financiare si dhe e kërkuesit dhe studiuesit shkencor të fushës së financave.

Pas përfundimit të programit, në sajë të njohurive të marra, rritet mundësia e punësimit në njësitë e ndryshme ekonomike të sektorit privat, si dhe në nivel drejtuesi në sektorin publik (në nivel qendror apo lokal). Te diplomuarit në këtë program studimi janë të aftë të marrin vendime të rëndësishme në kushtet e ndryshimit dinamik të ekonomise së tregut, të formulojnë koncepte dhe strategji për zhvillimin e sektorit financiar. Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimin të studimeve në ciklin e tretë (doktoratura), duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale. Në përfundim të këtij programi kandidatët do të jenë plotësisht të aftë për t'ju përshtatur kërkesave të tregut të punës duke u përfshirë në profesionet e mëposhtme:

Menaxher financiar, Auditues dhe kontabilist, analist, drejtues i planifikimit strategjik, specialist kredie, broker i letrave me vlerë, vlerësues i pasurive, agjent sigurimesh, agjent për menaxhimin e pasurive të paluajtshme, Nëpunës në administratën publike si inspektor doganor, inspektor tatimor; inspektor të kontrollit financiar, kasier banke etj.

Për të realizuar këtë kurrikul departamenti ynë do të bashkëpunojë jo vetëm me departamentet e tjera të këtij fakulteti apo fakulteteve të tjera të Shqipërisë, por dhe me kompanitë private dhe me institucionet publike për zhvillimin e praktikave mësimore, duke mos anashkaluar të gjitha institucionet studimore në vend dhe jashtë tij.

MASTER I BRENDSHËM APO I JASHTËM PËR INSTITUCIONIN	
☒ Master i organizuar nga Fakulteti	
Master i jashtëm	

4. STRUKTURA AKADEMIKE PËRGJEGJËSE DHE STRUKTURAT E TJERA BASHKËPUNUESE

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	Fakulteti Ekonomik Departamenti Financë – Kontabilitetit
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	1. Dept i Menaxhimit, mark-tur 2. Dept i gjuhëve të huaja 3. Fakultete të tjera Ekonomike në Shqipëri
Subjekte të tjera publike apo private.	Bizneset e Rajonit, subjekte private, institucione shtetërore

5. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimeve “Master i shkencave” realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 26 kredite për tezën, me kohëzgjatje 2 vite akademike, 4 semestra me nga 15 jave cdo semester . Në përfundim të këtij programi lëshohet diploma universitare: “Master i shkencave” në Finance

Programi i studimit “Master i shkencave” i pajis studentët me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti;

Studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Kohëzgjatja javore e procesit mësimor sipas semestrave:

- a. Semestri i parë 15 jave mësim
- b. Semestri i dytë 15 javë mësim
- c. Semestri i tretë 15 javë mësim,
- d. Semestri i katërt 4 javë praktikë profesionale dhe 11 javë përgatitje për mikrotezën
 - Orët mësimore në auditor janë për vitin e parë 750 ore dhe për vitin e dytë 745 ore.

- Numri i përgjithshëm i krediteve 120;
- Ngarkesa minimale javore. 20 orë

6. PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER SHKENCOR NE FINANCE CIKLI I DYTE VITI AKADEMIK 2014-2015

Viti I (parë)

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim	Kreditet	Ore ne auditor	Ore jashte auditorit	Tot	Semestr i	Frekuentimi
1.	Drejtimi Financiar Ndërkombetar i	B	6	75	75	150	I	I detyruar
2.	SNRF	B	6	75	75	150	I	I detyruar
3.	Metodologji kerkimi	C	6	75	75	150	I	I detyruar
4.	Vleresimi financiar i biznesit	B	6	75	75	150	I	I detyruar
5.	Qeverisja e korporatave	C	6	75	75	150	I	I detyruar
6.	Kontabiliteti drejtimi i Avancuar	B	6	75	75	150	II	I detyruar
7.	"Analiza e investimeve dhe menaxhimi i portofolit"	A	6	75	75	150	II	I detyruar
8.	Ekonometria	B	6	75	75	150	II	I detyruar
9.	Auditimi i PF dhe shërbimet e sigurisë dhe konsulencës	B	6	75	75	150	II	I detyruar
10.	Gjuhë e huaj	E	6	75	75	150	II	I detyruar
	GJITHSEJ VITI PARE		60	750	750	1500		

Viti II (dytë)

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim	Kredite t	Ore ne auditor	Ore jashte auditorit	Tot	Semestr i	Frekuentimi
1.	Teoria dhe praktika e sigurimeve	B	6	75	75	150	III	I detyruar
2.	Sistemi monetar evropian	B	6	75	75	150	III	I detyruar
3.	Exeli per manaxheret	A	6	75	75	150	III	I detyruar
4.	1. Menaxhimi i Financave personale 2.Fondete pensione 3. Marketingu i shërbimeve financiare	D	5 5 5	60 60 60	65 65 65	125 125 125	III III III	I detyruar
5.	Praktika profesionale	E	6	75	75	150	IV	I detyruar
6.	Tezë diplome	F	26	325	325	650	IV	I detyruar
	GJITHSEJ VITI DYTE		60	745	755	1500		

-Nga 3 lëndët me zgjedhje studenti duhet të zgjedhë **dy** prej tyre.

Shënim:Praktika profesionale do të zhvillohet : në semestrin e 4-t dhe do zgjasë 1 muaj (4jave)

7. DETYRIMET E MUNDSHME QË LIDHEN ME FREKUENTIMIN

Studentët janë të detyruar të frekuentojnë 75% të orëve të mësimit në auditor dhe të praktikave profesionale. Në rast se studentin nuk frekuenton mbi 50 % të orëve në auditor , studentin shpallet përsëritës për atë lëndë. Për të kaluar në semestrin e tretë, studentin që ndjek studimet në ciklin e dytë, “Master i Shkencave”, sistemi me kohë të plotë, duhet të ketë përfituar minimum 45 kredite.”

8. FORMAT E STUDIMIT DHE TË VLERËSIMIT

-Forma e studimit me kohë të plotë

-Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e disiplinës a modulit dhe vlerësimi përfundimtar.

- Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit përfaqëson 30% të vlerësimit total. Përbërësit e vlerësimit të vazhduar bëhen nga çdo pedagog në programin e disiplinës a modulit.

Format e provimeve janë provime me shkrim, sipas programit të çdo lënde. Gjithashtu, për lëndët, parashikohet verifikim i vazhdueshëm i njohurive si dhe vlerësim i njohurive përgjatë semestrit.

Program studimi i ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master i shkencave” fillon veprimtarinë akademike në vitin e parë, për vitin akademik 2014 - 2015, në rast se në këtë program studimi regjistrohen së paku 10 studentë.

Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 4 sezone: sezoni i Dimrit (Shkurt, Mars); sezoni i Verës (Qershor, Korrik); sezoni i vjeshtës (Shtator) dhe sezoni plotësues. Në sezonin plotësues për çdo disiplinë apo modul do të ketë vetëm një datë provimi. Ai nuk mund të shlyejë më shumë se 7 (shtatë) provime në sezonin e vjeshtës dhe jo më shumë se 2 (dy) provime në një ditë.”

Ato miratohen dhe shpallen nga Dekani jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit.

Diplomimi bëhet në sezonin e dimrit (mars), në sezonin e verës (korrik) dhe në sezonin e vjeshtës (shtator).

Datat përcaktohen në çdo fillim të vitit akademik me vendim dekanati.

Plani mësimor përfshin disiplina të formimit të përgjithshëm, disiplina të formimit karakterizues, disiplina formuese me zgjedhje nga studentët, praktika profesionale dhe teza e Diplomës të cilat do të realizojnë 120 kredite që përfshijnë orë në auditore të planifikuara për leksione dhe seminare etj.

Fakulteti Ekonomik shpall Programin e Studimit “MASTER I SHKENCAVE” NË FINANCË – KONTABILITET në mjediset e Fakultetit dhe në faqen zyrtare të Universitetit për t’u njohur nga të gjithë kandidatët e interesuar.

Kandidatët për programin e studimit “MASTER SHKENCAVE” NË FINANCË – KONTABILITET aplikojnë pranë Sekretarisë së Fakultetit të Ekonomisë sipas datave që shpallen në mjediset e Fakultetit dhe në Internet, duke përmbushur kriteret e pranimit.

Titullin e këtij Programi studimi e marrin studentët që kanë fituar 120 kredite nga plani mësimor i Programit dhe kanë marrë pjesë në masën 75 % në veprimtaritë mësimore profesionale.

Studentët që fitojnë në Programin e studimit “MASTER SHKENCAVE” NË FINANCË – KONTABILITET paguajnë tarifën me keste të përcaktuar nga institucioni. Kesti i parë parashikon pagesën në masën 30% të tarifës totale dhe paguhet menjëherë me regjistrimin e studentit në programin përkatës. Për të kaluar në semestrin e tretë, studenti që ndjek studimet në ciklin e dytë, “Master i Shkencave”, sistemi me kohë të plotë, duhet të ketë përfunduar minimum **45 kredite**.

Pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të programit të studimit, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës dhe nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi deri në përfundim të vitit akademik, konsiderohen studentë ngelës/përsëritës. Për lëndët përsëritëse, studentët paguajnë çdo vit akademik dyfishin e tarifës për kredit të parashikuar në këtë vendim.

Përcaktimi i sipërpërmendur do të aplikohet për vitin akademik 2014 -2015 e në vazhdim, gjithashtu edhe për të gjithë studentët e regjistruar në vitet akademike të mëparshme, të cilët nuk kanë përfunduar programet përkatëse të studimeve dhe do të jenë përsëritës

Rezultatet dhe niveli cilësor i veprimtarive në Programin e Studimit “MASTER SHKENCAVE” NË FINANCË – KONTABILITET vlerësohen çdo vit sipas modaliteteve të përcaktuara nga njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe ky vlerësim bëhet i njohur për të gjithë.

Studentët që vazhdojnë programin “MASTER SHKENCAVE” NË FINANCË – KONTABILITET përfitojnë të gjitha të drejtat e shkollimit për Ciklin e Dytë të Studimeve në bazë të ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”

Studentet e programit të studimit “MASTER SHKENCAVE” NË FINANCË – KONTABILITET duhet të japin deri në diplomim provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

-Në përfundim të Programit të studimit Master me kohë të plotë në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit “Fan S.Noli” diplomantët realizojnë një provë finale në formën e mbrojtjes së tezës së diplomës, që vërteton aftësimin profesional dhe shkencor të studentëve. Punimi i Mikrotezës realizohet në grupe të përbërë nga 1–3 studentë.

Mbrojtja e Tezës së Diplomës bëhet publike dhe konsiston në një punim me shkrim. Ky punim parakupton një studim të thelluar të literaturës shkencore dhe vëzhgimi në praktikë, reflektimin

e përvojës vetjake të fituar gjatë formimit teorik dhe praktik dhe dhënien e përfundimeve dhe të sugjerimeve mbi argumentin e përzgjedhur nga vetë studenti.

Me anë të punimit të diplomes student tregon se ka përvetësuar temën, e ka punuar atë me metodën që i përgjigjet punimit, njeh lëndën, terminologjinë dhe literaturën e përdorur profesionale dhe është i aftë ta citojë atë në mënyrë të rregullt..

Në punimin e diplomes duhet të dalë në dukje aftësia e të menduarit dhe e punës së pavarur të studentit, respektivisht aftësia për të nxjerrë përfundime dhe për të bërë propozime për zgjidhjen e problemit të caktuar .

Pjesa e mikrotezës për diplomën “MASTER I SHKENCAVE” duhet të ketë si rregull jo më pak se 80 dhe jo më shumë se 100 faqe kompjuterike të formatit A4. Referencat shenimet në fund të faqes nuk përfshihen në këtë përlllogaritje . Numri maksimal i karaktereve në një faqe për punimin e mikrotezës është maximum 2000 karaktere.

A. Studenti duhet të përgatisë një punim me shkrim rreth 80 -100 faqe A4, në fushën e kërkimit në lidhje me karakterin zbatues të disiplinës të përzgjedhur nga ai vetë. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore.

B. Studenti duhet të përgatisë një punim teorik krahasues, me shkrim 80 -100 faqe A4, në fushën e Ekonomisë dhe të përvetësimit të disiplinës përkatëse, të përzgjedhur nga ai vetë. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore sipas programit që ai ka shlyer në programin përkatës.

Të gjitha temat e diplomës së programit bëhen nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës. Të gjithë pedagogëve, u lind e drejta të bëjnë udhëheqje të temave të diplomës për Programin me kohe të plotë. Gjithashtu, temat e diplomave kanë edhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij.

Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin brenda muajit dhjetor të semestrit të parë të vitit të dytë. Studenti, nëse e shihet të arsyeshme, mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit brenda afatit të përcaktuar më lart. Platforma me bibliografinë përkatëse dorëzohet përfundimisht pranë Departamentit.

Për t’u pranuar në mbrojtjen e temës, studentin duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit, pra të ketë marrë 120 kredite.

Punimi dorëzohet në tre kopje 2 jave përpara datës së mbrojtjes. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate ose nuk kanë marrë 120 kredite, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në

sesionin perkates. Vetëm pasi të kenë shlyer detyrimet e mësipërme dhe të kenë dorëzuar punimin ne kohe, studentëve u lind e drejta të bëjnë mbrojtjen e temës .Komisioni i vlerësimit të temave të diplomave përbëhet nga 3 (tre) pedagogë, prej të cilëve njëri është oponent. Komisioni caktohet nga Dekani i Fakultetit. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh tre kritere: a) përmbajtja origjinale, dobia e punimit dhe zbatimi praktik; b) mënyra e paraqitjes me gojë dhe c) mesatarja e studimeve të Programit te ciklit te dyte me kohe te plotë .

STRUKTURA E PUNIMIT

Punimi duhet të shkruhet me shkrim Times New Roman, Font 12, Hapësira midis rreshtave 1,5.

1. HYRJE: PËRSE KJO TEMË? (4-6 faqe)
2. SHQYRTIMI I LITERATURES SE FUSHES DHE TE CESHTJES 7-8 FAQE
3. ARGUMENTET DHE ANALIZA E TË DHËNAVE (60 faqe)
5. PËRFUNDIME, PROPOZIME, BIBLIOGRAFI (4-6 faqe)

9. INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION TË PROGRAMIT

Fakulteti i Ekonomisë është organizuar dhe funksionon në tre njësi administrative - akademike (godina).

Shpërndarjen e fasiliteve, mjediseve, si dhe kapacitetet e tyre për realizimin e suksesshëm të procesit akademik, paraqiten si më poshtë :

Salla e leksioneve : 9 auditorë, në të cilët zhvillojnë procesin akademik 1840 studentë ose (grupe seminaresh), secila e pajisur me 1 set kompjuterik, të përberë nga një 1 kompjuter, 1 projektor nëpërmjet të cilit informacioni sillet përpara studentit në mënyrë inter-aktive, Hardware Audio.

Salla e Seminareve: Numri i tyre është 16 me një kapacitet prej 960 studentësh, secila e strukturuar. Salla e seminarit, në varësi të nevojave mësimore pajiset menjëherë me 1 set kompjuterik (i përshkruar me sipër).

Laboratorët: 4 salla.

Biblioteka: përmban strukturën e nevojshme për të vendosur një numër prej 5600 librash, 1kompjuter për përdorim administrativ, 1 printer SharePoint, 36 kompjutera për përdorim nga studentët në të cilët mund te shihen titujt elektronik, 30 tavolina për studentet dhe 1 tavoline ovale për lexim.

Sekretaria Mësimore: Është njësia pranë së cilës zhvillohet procesi administrativ brenda Fakultetit, e cila është e pajisur me paisjet e duhura për zhvillimin normal të punës

administrative, dhe konkretisht 3 sete Kompjuterash, 3 printer-skaner SharePoint dhe 2 printer – fotokopje SharePoint..

Departamentet: Në total janë 4 salla departamentesh të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për kryerjen e Funksioneve të tyre si Sete kompjuterike, printer SharePoint etj.

Salla e Pedagoqeve: E parashikuar për pedagoget e Fakultetit me qëllim mbarëvajtjen e detyrave për procesin mësimor, por edhe si një kënd çlodhjeje për pedagogët në pushimet ndërmjet orëve mësimore. Në të gjenden 6 sete Kompjuterësh, 1 printer SharePoint, rafte për arkiva, si edhe këndi i çlodhjes.

Zyrat e Dekanit: Këto zyra janë të pajisura me 2 sete Kompjuter, 2 printera, rafte arkivimi, Bibliotekë personale, kënd pritjeje etj. me qëllim kryerjen e të gjithë veprimtarisë administrative të personelit drejtues.

Arkiva qendrore: Është e strukturuar në mënyrë të tillë që pranë saj të depozitohen të gjithë materialet dhe dokumentet që gjenerohen nga Njësitet dhe që arkivohen për një periudhë afatgjatë ose të përhershme. Ajo është e pajisur me 2 set kompjuterik, 16 rafte për magazinimin e paisjeve kompjuterike, si edhe rafte për arkivimin e dokumenteve.

Ambientet e leksioneve dhe seminareve kanë siguruar një hapësirë të madhe për studentët. Në ambientet e leksioneve studion një numër maksimal prej 1380 studentësh, ndërsa për një sallë seminaresh është përcaktuar një numër maksimal prej 35 studentësh. Pra, parë në këndvështrimin praktik, përmes këtij kapaciteti, studentit i krijohet një mjedis komod dhe i mjaftueshëm për ndjekjen e procesit të mësimdhënies.